

PERJASHTIMET

ZJARR

- Nuk do të mbulohen demet e shkaktuara nga implozioni.

- Nuk do të mbulohet fitimi i munguar dhe demet vijuese të çdo lloji dhe natyre të tilla si demet për shkak të vonësive, moskryerjes, humbjes së kontratës, gjobat etj.

- Nuk do të mbulohen demet e mëposhtme:

a. demtimi nga zjarri i objekteve të siguruara shkaktuar nga venia e tyre në zjarre utilitare (zjarre..... përdorimi ose shërbimi) ose nga trajtimi i tyre me nxehje; kjo do të zbatohet gjithashtu për objektet në të cilat ose përmes së cilave prodhohet ose përçohet zjarri ose nxehësia utilitare;

b. djegiet sipërfaqesore, përveç se kur shkaktohen nga njëri prej rreziqeve të mbuluara në nenin 8;

c. demit në motoret me djegie të brendshme shkaktuar nga shpërthimet e ndodhura brenda dhomes së djegies;

d. demit i shkaktuar në kontaktet e çelësive elektrike si rrjedhojë e presioneve të gazrave që lindin brenda tyre;

e. demit në çdo makineri dhe aparaturë elektrike, ose në çdo pjesë të instalimit elektrik shkaktuar nga rryma elektrike me ose pa ndodhjen e zjarrit (p.sh. si pasoje e mbirrymes, tejkalimit të kufinjve normale të tensionit, mbitensionit ose nentensionit, defekteve të izolimit si qarqe të shkurtera, kontakte trupore ose defekte të keqzimit; kontaktit të pamjaftueshëm, mosfunksionimit të instalimeve të matjes, kontrollit ose sigurisë);

f. demit në çdo makineri dhe aparaturë elektrike, ose në çdo pjesë të instalimit elektrik si pasoje e rrufesë, nëse ky dem nuk është shkaktuar nga goditja direkte e rrufesë;

g. demit shkaktuar me dashje ose nga pakujdesia e rende e të Siguruarit;

h. demit shkaktuar direkt ose indirekt nga veprimet (aktet) keqdashëse.

Me veprime (akte) keqdashëse do të kuptohet humbja, shkatërimi ose demtimi (shkaktuar nga zjarri, eksplozioni ose të tjera) e Pasurisë së Siguruar shkaktuar direkt nga demtimet keqdashëse të çdo personi ose grup personash, pavarësisht nëse një akt i tillë është bërë ose jo si pasoje e prishjes së qetesisë publike.

i. demit i shkaktuar me dashje ose nga pakujdesia e rende e anëtarëve më të mëdhenj të familjes së të Siguruarit

- Ky sigurim nuk do të mbulojë demtimin e objekteve të siguruara ose shpenzimet e siguruara të lindura ose të shkaktuara drejtpërdrejt ose indirekt si pasoje e:

a. shpërthimit berthamor, rrezatimit berthamor dhe ndotjes radioaktive;

b. luftës së çdo lloji, invazionin, luftime të tjera të armatosura pavarësisht nëse është deklaruar lufta ose jo, luftën civile;

c. turbullira civile, revolucionet, levizje separatiste, kryengritje popullore, rebelime, revolta, puçe, grushte shteti, eksode;

d. konfiskime, rekuizime, shtetezime të detyruara të kryera me urdher të çfaredollos qeverie apo autoriteti shtetëror;

e. trazira, greva, lokauti, sabotimi, terrorizmi. Terrorizmi do të konsiderohet kryerja e veprimeve të dhunshme ndaj pasurisë nëpërmjet vjedhjeve, demtimeve e shkatërrimeve masive që kanë si qëllim turbullimin e rendit publik dhe ngjalljen e frikës e të pasigurisë së publikut;

f. shpalljen e ligjit të luftës, deklarimit dhe vendosjes së gjendjes së jashtëzakonshme, anarkia ose mosfunksionimi i shtetit, qofte edhe në pjesë të caktuara të vendit.